

VENDIM
Nr. 60, datë 2.4.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.97, DATË 9.5.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘KARAVASTA SOLAR’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT–KARAVASTA, LUSHNJË DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140 mwp”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144/4 prot., datë 29.3.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 8.5.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Karavasta Solar Park 2’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike me vendndodhje në zonën e Remasit–Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140mwp””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 9.5.2022, ka vendosur: 1. Të licencojë shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me vendndodhje në zonën e Remasit–Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mwp, për një afat 30-vjeçar; 2. Shoqëria të depozitojë në ERE, brenda datës 20.6.2022, përgjigjen/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me informacionin kadastral të Deklaratës Mjedisore për zhvillimin e projektit të Karavastasë; 3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushtit sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi.

- Pas një korrespondence të gjatë të zhvilluar me vetë shoqërinë dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), rezulton se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin nr. 97/2022, të Bordit të ERE-s, duke depozituar në ERE shkresat e korrespondencës së mbajtur me AKM-në dhe qëndrimin e saj në lidhje me zhvillimin e projektit të Karavastasë.

- Shoqëria, me shkresën nr. 736/11 prot., datë 12.3.2024, ka depozituar Certifikatën e Kolaudit, sipas përcaktimeve të nenit 6, “Ndërtimi dhe kolaudimi”, të marrëveshjes së zhvillimit datë 31.7.2020, për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e impianteve fotovoltaike me vendndodhje në zonën Remas–Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, Shqipëri” nga “Karavasta Solar” sh.p.k. dhe po ashtu ka raportuar se impianti fotovoltaike ka hyrë në prodhim.

- Për gjithë sa depozituar nga shoqëria, rezulton se kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit nr. 97, datë 9.5.2022, është plotësuar, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet. Me shfuqizimin e pikës 2, nuk gjen më zbatim as pika 3, e vendimit nr. 97/2022, dhe si e tillë vlerësohet të shfuqizohet dhe pika 3 e këtij vendimi.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97/2022, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k. dhe Ministrinë e infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi